GJASHTË ELEMENTET BAZË TË

“SOFT POWER ose

“PUSHTETIT TË BUTË”

TË KOMBIT SHQIPTAR



Sipas Prof. Joseph S. Nye nga Harvard University:

“Pushteti i butë është aftësia për të ndikuar te të tjerët përmes tërheqjes dhe empatisë, jo përmes detyrimit apo shpërblimit material.”

Unë kësaj i shtoj një parim të thjeshtë:
“Nëse përfaqëson kombin shqiptar, bëje këtë me krenari dhe dinjitet.”

Shqiptarët kanë elemente të jashtëzakonshme të këtij pushteti të butë, që shumë kombe të tjera nuk i kanë.

A) SHQIPTARËT – MBROJTËS TË QYTETËRIMIT PERËNDIMOR

Rezistenca shekullore kundër pushtimit osman, e përqendruar në figurën e Skënderbeut, e vendos Shqipërinë në altarin e kombeve që mbrojtën qytetërimin perëndimor.

Trashëgimia jonë ilire dhe qëndresa historike janë pjesë e identitetit tonë evropian.

B) SHQIPTARËT – BURRA SHTETESH EDHE PA PASUR SHTET

Edhe kur nuk kishin shtetin e tyre, shqiptarët ndërtuan dhe drejtuan shtete të tjera.

Ndër figurat më të njohura:

Perandori Dioklecian - 284 AD - 305 AD.
Papa Klementi XI - 1649 - 1721
Francesco Crispi - 1818 – 1901
Mehmet Ali Pasha i Kavallës - 1769-1849

Kjo është dëshmi e aftësisë sonë shtetformuese dhe vizionit politik.

C) MËSHIRA KRISTIANE DHE SHQIPTARE

Figura e Nënë Terezës i dha botës një mësim universal: Mëshirë, dinjitet për të varfrin dhe

dashuri për njeriun. Humanizmi shqiptar është pjesë e Soft Power-it tonë.

D) MUNGESA E ANTISEMITIZMIT – BESË DHE MIKPRITJE

Shqipëria është i vetmi vend në Evropën e pushtuar ku asnjë hebre nuk iu dorëzua nazistëve.

75 shqiptarë janë të njohur nga Yad Vashem si "Fisnikë midis Kombeve".

Kodi ynë i nderit – Besa – dhe parimi "Shtëpia është e Zotit dhe e mikut" e bëri Shqipërinë një strehë shpëtimi.

E) GJENIALITETI I LETRAVE SHQIPE – ISMAIL KADARE

Ismail Kadare, i përkthyer në mbi 50 gjuhë, është një nga zërat më të fuqishëm kulturorë të Shqipërisë në botë.

Letërsia jonë është një instrument i fortë i Pushtetit të Butë.

F) TOLERANCA FETARE

Shqiptarët, ndonëse të ndarë në disa besime fetare, nuk kanë njohur luftëra civile fetare.

Harmonia jonë fetare është model unik në Evropë.

POR...

Soft Power nuk mjafton vetëm ta përmendim. Duhet ta mbrojmë dhe ta zhvillojmë.

Nuk mund të pretendojmë turizëm kulturor pa Galeri Kombëtare të Arteve funksionale!?
Pa Muze Kombëtar dinjitoz!?
Pa Teatër Kombëtar!?
Pa Bibliotekë Kombëtare në standard evropian!?

Nëse Parisi ka Luvrin, Londra British Museum, New York Broadway, Viena Bibliotekën

Kombëtare – ne duhet të kemi institucionet tona të hapura, funksionale dhe krenare.

Ne kemi një komb fisnik.
Detyra jonë është ta trajtojmë si të tillë.

“ZGJIDH SHQIPËRINË: PUNO. INVESTO. JETO.”

PUSHTETI I BUTË I KOMBIT SHQIPTAR

DHE NDIKIMI QË KA NË TURIZËM, PUNËSIM,

NJOHJE TË KOMBIT TONË SHQIPTAR!

“Pushteti i butë është aftësia për të ndikuar te të tjerët përmes tërheqjes, empatisë, dhe jo përmes detyrimit apo shpërblimit material.”

Joseph S. Nye Jr., Harvard Kennedy School

“Nëse e përfaqëson kombin tonë shqiptar, bëje këtë me krenari dhe dinjitet.”



Me “babain” e konceptit të Pushtetit të Butë, Prof. Joseph S. Nye Jr., gjatë një prezantimi në Starr Auditorium, Belfer Building, Kennedy School of Government, Cambridge, Massachusetts, SHBA.

GJERGJ KASTRIOTI - SKËNDERBEU

HEROI I PATHYESHËM SHQIPTAR,

MBROJTËSI I QYTETËRIMIT PERËNDIMOR

GJERGJ KASTRIOTI - SKËNDERBEU

HEROI I PATHYESHËM SHQIPTAR,

MBROJTËSI I QYTETËRIMIT PERËNDIMOR

Për të shënuar 100-vjetorin e Pavarësisë, më 28 Nëntor 2012, Ambasada e Shqipërisë vendosi bustin e Heroit Kombëtar Shqiptar, Skënderbeut.
Ceremonia e zbulimit u ndoq nga autoritete britanike të Bashkisë së Westminster-it, si dhe nga bashkësia shqiptaro-britanike në Londër dhe në Mbretërinë e Bashkuar.

Busti i Gjergj Kastriotit Skënderbeut u realizua nga skulptori shqiptar Kreshnik Xhiku. Ai u vendos në adresën 113 Inverness Terrace, London W2 6JH, Bayswater,
më 28 Nëntor 2012, për nder të 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë.

27 June 2013 – Buckingham Palace

Vendosja e bustit të Skënderbeut në Londër u bë me dijeninë dhe mbështetjen e **Madhërisë së Saj, Mbretëreshës Elizabeth II.**

Po ashtu, gjatë paraqitjes së letrëkredencialeve, një **lahutë shqiptare,** e punuar me mjeshtëri artistike nga mjeshtri Pirro, iu dorëzua Madhërisë së Saj Mbretëreshës.

Ajo u ekspozua në Sallën e Ambasadorëve gjatë audiencës mbretërore dhe më pas u përfshi në Koleksionin e Artit të Mbretërisë së Bashkuar.

Diplomatët shqiptarë vendosin bustin e Skënderbeut në fshatin arbëresh Munxhufuni, Itali, më 4 gusht 2013, në Sheshin “Skënderbeu”, në prani të autoriteteve rajonale dhe vendore.

SHQIPTARËT

BURRA SHTETESH
EDHE PSE VETË NUK
KISHIN SHTET





DIOKLECIANI ISHTE NJË PERANDOR ILIR I ROMËS. NE KRENOHEMI ME TRASHËGIMINË E TIJ, E CILA VAZHDON TË JETOJË PËRJETËSISHT NË PALLATIN E TIJ NË SPALATUM, SOT SPLITI NË KROACI.

REVISTA NATIONAL GEOGRAPHIC

SHQIPTARËT I DHANË VATIKANIT 4 PAPE:

Papa Shën Eleuteri
(175–189)

Papa Shën Caius
(283–296)

Papa Gjoni IV
(640–642)

Papa Klementi XI
(1700–1721)



Papa Klementi XI, i lindur me emrin **Giovanni Francesco Albani**, ishte kreu i Kishës Katolike dhe sundimtar i Shteteve Papnore nga 23 nëntori 1700 deri në vdekjen e tij në mars 1721.
Klementi XI ishte një mbrojtës dhe përkrahës i arteve dhe i shkencës.



National Geographic Magazine

FRANCESCO CRISPI

Francesco Crispi (1819–1901), figurë kyçe e Rilindjes italiane dhe Kryeministër i Italisë, ishte me prejardhje arbëreshe nga Siçilia.

Ai e quante veten “shqiptar me gjak dhe me zemër”, fliste arbërisht dhe ishte ndër protagonistët e bashkimit të Italisë në vitin 1860.

Arbëreshët i dhanë Italisë një burrë shteti si Crispi, duke ruajtur ndërkohë kulturën dhe gjuhën shqipe, të cilën studiuesit e tyre e kodifikuan ndër të parët.

Muhammad Ali Pasha (1769–1849) ishte pasha me origjinë shqiptare, i njohur gjerësisht si themeluesi i Egjiptit modern në vitin 1805. Ai sundoi deri më 1848. Dinastia e tij sundoi deri në vitin 1952.

(Revista National Geographic)

MËSHIRA KRISTIANE DHE SHQIPTARE

Nënë Tereza (Anjezë Gonxhe Bojaxhiu, 1910–1997) ishte murgeshë katolike shqiptare dhe humaniste, e lindur në Shkup në një familje shqiptare. Ajo mori Çmimin Nobel për Paqen në vitin 1979 dhe u shenjtërua në vitin 2016 me emrin **Shenjtorja Nënë Tereza**.

SHQIPTARËT KUNDËR ANTISEMITIZMIT

Të mbështetur në vlerat më të larta morale të mishëruara në BESËN SHQIPTARE, qindra hebrenj u strehuan pa kushte nga shqiptarë të thjeshtë, kryesisht në zonat rurale të vendit.

Njëqind për qind e hebrenjve në Shqipëri u shpëtuan nga Holokausti.
Edhe autoritetet shqiptare, gjatë pushtimit gjerman, i mbrojtën dhe i shpëtuan hebrenjtë.

Historia e pathënë e hebrenjve që u shpëtuan plotësisht në Shqipëri përgjatë historisë, veçanërisht gjatë Holokaustit, është një mjet i rëndësishëm për ta çuar këtë histori të drejtë në botë.

Historia e Prof. Dr. Scarlet Epstein, jeta e së cilës dhe e familjes së saj u shpëtua në Shqipëri.
Ajo ndërroi jetë në vitin 2014, duke i thënë të gjithëve:

“SHQIPËRIA MA SHPËTOI JETËN.”

Emrat e 75 familjeve shqiptare që shpëtuan hebrenj janë të gdhendur në Muzeun Përkujtimor **Yad Vashem** në Jerusalem, ku nderohen si:

“FISNIKËT MIDIS KOMBEVE”.

“SHQIPTARËT NA SHPËTUAN JETËN”

Znj. Felicita Jakoel, Presidente e Shoqatës Shqipëri–Izrael, duke paraqitur fakte të dokumentuara mbi mënyrën se si shqiptarët, nga qytetarët e thjeshtë deri te zyrtarët e lartë shtetërorë gjatë periudhës së pushtimit gjerman, mbrojtën dhe shpëtuan hebrenjtë në Shqipëri.

GJENIALITETI I LETRAVE SHQIPE:

ISMAIL KADARE DHE JEHONA NDËRKOMBËTARE E VEPRËS SË TIJ


KADARE
Œuvres
Œuvres 1
Œuvres 2
Œuvres 3
Œuvres 4
Œuvres 5
Œuvres 6
Œuvres 7
Œuvres 8
Œuvres 9
Œuvres 10
Œuvres 17
Œuvres 18
Œuvres 19
Œuvres 20
Fayard
LE GÉNÉRAL DE L'ARMÉE MORTE
NOVEMBER

Një moment krenarie: dorëzimi me respekt i librit “Shqiptarët, Lisa mbi Truallin Ilir” shkrimtarit tonë të madh shqiptar, ISMAIL KADARE. Mirovicë, 2008.

TOLERANCA FETARE TEK SHQIPTARËT

RAST UNIK NË BOTË, KU MUNGOJNË PLOTËSISHT KONFLIKTET MIDIS BESIMTARËVE TË NDRYSHËM BRENDA TË NJËJTIT KOMB.

Albania and the Albanian *people offer one*
of the strongest examples of peaceful
coexistence among faiths.

Kisha Katolike e Thethit, e ndërtuar në vitin 1892, është një monument historik prej guri, i vendosur në zemër të fshatit Theth, në Alpet Shqiptare.

Islami në Shqipëri, besim fetar i shënuar nga toleranca dhe bashkëjetesa.

Xhamia e Et’hem Beut, e ndërtuar në vitin 1830.fetar

Kisha Ortodokse Shqiptare e Ardenicës (1282), ku në vitin 1451 Gjergj Kastrioti Skënderbeu u celebrua me Andronika Arianitin.

BEKTASHIZMI NË SHQIPËRI ËSHTË NJË RRYMË LIBERALE ISLAMIKE QË PROMOVON DASHURINË NJERËZORE, TOLERANCËN DHE HARMONINË SHPIRTËRORE.

Shqipëria është një shembull i gjallë i bashkëjetesës paqësore ndërmjet feve të ndryshme. Gjatë vizitës së Papa Françeskut, më shumë se 300 000 shqiptarë u mblodhën në Sheshin “Nënë Tereza” për ta pritur. Vlen të theksohet se mbi gjysma e të pranishmëve i përkisnin besimit islam.

PUSHTETI I BUTË ËSHTË NJË INSTRUMENT EFEKTIV PËR PROMOVIMIN E SHQIPËRISË, KOSOVËS DHE SHQIPTARËVE NË RANG GLOBAL.

Gjithçka e paraqitur këtë mbrëmje, dhe shumë më tepër, mund të gjendet në:

Malberisha.com

Ju faleminderit për vëmendjen!